USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Arbër Lleshi

Drejtor Menaxhues, BONEVET

Duke u nisur nga përvoja ime personale, mendoj që angazhimi im në aktivitete jashtëshkollore ka qenë thelbësor në arritjet e mia individuale dhe në kontributin që kam dhënë në shoqëri. Kam studiuar në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut dhe në Universitetin e Sheffield. Qysh kur isha në shkollë të mesme kam dhënë kontributin tim në komunitet duke qenë aktiv në programe joformale dhe klube bamirësie. Përveç punës me BONE-VET kam menaxhuar edhe projektin ClimateLaunchpad për Kosovë, një garë kjo më e madhja në botë për biznese të reja të gjelbërta që luftojnë ndryshimin klimatik.

Konsideroj që kontributi im vullnetar më i rëndësishëm është bashkëthemelimi dhe udhëheqja për katër vite e parkut kulturor "Ali Podrimja". Ky është amfiteatri i parë në qytetin e Gjakovës që ndër tjerash ka rikthyer kinemanë pas 25 vitesh në këtë qytet dhe vazhdon të jetë skenë kryesore e shfaqjeve artistike. Përmes organizatës joqeveritare DU ART, unë dhe ekipi i organizatës gjatë pandemisë COVID - 19 në vitin 2020, organizuam projektin kreativ unik "Drive-In Cinema", ku adhuruesit e kinematografisë kishin mundësi të shijonin filma nga makinat e tyre.

Jam i përfshirë në disa fushata për mbledhjen e fondeve për projekte shoqërore në KosovaIdeas, ku veçoj arritjen në renovimin dhe pasurimin me libra të bibliotekës së shkollës "Mazllum Këpuska" në vitin 2019.

#dikurjashehhajrin #hajri #jashehhajrin

Iniciativa "Dikur ja sheh hajrin" në Gjakovë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.